



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 shkurt 2024
Nr. Ref.: RK 2361/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI92/23

Parashtues

Mimoza Pajaziti

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 474/2022 të 22 dhjetorit 2022

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Mimoza Pajaziti, me vendbanim në Ferizaj, e përfaqësuar nga Sevdail Robelli, avokat nga Gjilani (në tekstin e mëtejme: Parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 474/2022] e 22 dhjetorit 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të kontestuar, me të cilën parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të saj, të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejme: Kushtetuta], në lidhje me nenet 6 [E drejta për një proces të rregullt, 13 [E drejta për ankim efektiv] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [në tekstin e mëtejme: KEDNJ].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023 u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur, e cila ka shfuqizuar Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese nr. 01/2018. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë para shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për atë sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 28 prill 2023, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Gjykata).
7. Më 3 maj 2023, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin Nr. GJR. KI92/23 caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu Krasniqi, gjyqtare raportuese dhe me Vendimin KSH. KI92/23 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
8. Më 31 maj 2023, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, një kopje të kërkesës së parashtruesit iu dërgua Gjykatës Supreme.

9. Më 26 qershor 2023, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Ferizaj [në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore] dorëzimin e dosjes së plotë (origjinale) të lëndës (PKR. nr. 65/20-2021:149284).
10. Më 7 korrik 2023, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës.
11. Më 31 janar 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 17 dhjetor 2018, Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj ngriti kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda [në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria Themelore] kundër parashtrueses së kërkesës për shkak të dyshimit se kjo e fundit kishte kryer veprën penale “Vrasje” sipas nenit 187 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejshëm: KPRK]. Parashtruesja e kërkesës ishte me vendqëndrim në Gjermani.
13. Ministria e Drejtësisë-Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë, më 13 mars 2019, përmes shkresës me referencë [MD/DBGJ/1067/19-DBJN/2018/1054], dhe më 3 korrik 2019, nëpërmjet letrës me referencë [MD/DBGJ/3075/19-DBJN/2018/1054], kërkoi nga autoritetet gjermane ekstradimin e parashtrueses së kërkesës në Republikën e Kosovës.
14. Më 23 korrik 2019, autoritet gjermane njoftuan Ministrinë e Drejtësisë se kishin arrestuar parashtruesen e kërkesës dhe ishin në pritje të ekstradimit të saj në Kosovë.
15. Më 18 dhjetor 2019, Policia e Kosovës arrestoi parashtruesen e kërkesës. Prokuroria Themelore nëpërmjet Aktvendimit mbi ndalimin e personit të dyshuar vendosi që ta mbante parashtruesen e kërkesës në ndalim prej 48 (dyzet e tetë) orësh, për shkak të rrezikut se e njëjta mund të arratisë në Gjermani.
16. Më 12 maj 2020, Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, ngriti aktakuzën [PP.I.nr. 217/18] kundër parashtrueses së kërkesës për shkak të veprave penale “Vrasje e rëndë” dhe “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” sipas nenit 179 respektivisht nenit 374 të KPRK-së.
17. Më 17 qershor 2020, Gjykata Themelore në Ferizaj mbajti seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën parashtruesja e kërkesës nuk e pranoi fajësinë sipas aktakuzës së ngritur ndaj saj.
18. Më 22 qershor 2020, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën Themelore për hedhje të aktakuzës.
19. Më 10 korrik 2020, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktvendimit [PKR. nr. 176/19] refuzoi si të pabazuar kërkesën për hedhje të aktakuzës, me arsyetimin se nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.
20. Më 22 mars 2021, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 65/20] e shpalli fajtores parashtruesen e kërkesës për veprën penale “Vrasje e rëndë”, dhe “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, sipas nenit 179, paragrafit 1, respektivisht nenit 374, paragrafit 1 të KPRK-së dhe ia shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej

18 (tetëmbëdhjete) vitesh. Gjykata Themelore arsyetoi si në vijim: (i) Në lidhje me rrethanat e rastit, Gjykata Themelore theksoi se “Me datë 31.08.2018, në intervalin kohor mes orës 20.35 dhe 21.00 në Ferizaj, përkatësisht në afërsi të restorantit “Ujvara”, me dashje dhe në mënyrë direkte, ka privuar nga jeta tani të ndjerin A.K, në atë mënyrë që duke shfrytëzuar besimin dhe sinqeritetin e tij, meqenëse të njëjtit janë njohur dhe kanë qenë në lidhje dashurie më parë, ashtu që e pandehura me përgatitje paraprake, fillimisht vihet në kontakt me të ndjerin përmes telefonit, pastaj kërkon nga i njëjti të takohen, duke mos i dhënë ndonjë arsye konkrete, ndërsa ditën kritike në kohën dhe vendin e lartshënuar e lë takimin me të, e më pas me tu takuar me tani të ndjerin, me veturën e tij të markës “Land Rover” me ngjyrë të bardhë, futen në një rrugë qore dhe derisa gjenden brenda veturës, e qëllon dy herë me armë zjarri...”. (ii) Në lidhje me kohën e vdekjes, Gjykata Themelore arsyetoi se: “Në raportin shtesë të autopsisë ekspertit mjeko-ligjor M.G., në lidhje me kohën e vdekjes së tani të ndjerit, i njëjti në bazë të dhënave dhe rrethanave të rastit si dhe të dhënat e regjistruara për fenomenet kufomore në lidhje me kohën e vdekjes së tani të ndjerit ka dhënë konkludimin e tij se vdekja ka ndodhur në intervalin kohor mes datës 31.08.2018 rreth orës 22.00, kur edhe është parë i gjallë herën e fundit nga familjarët dhe datës 02.09.2018 rreth orës 16.25 kur është gjetur i vdekur, ndërsa në bazë të shenjave kufomore ekspertit ka theksuar se mund të deklarohet se nga momenti i ekzaminimit në vendin e ngjarjes rreth orës 19.00 të datës 02.09.2018 vdekja ka ndodhur jo më pak se 24 orë më përpara”. (iii) Në lidhje me provat shfajësuese, Gjykata Themelore theksoi se: “Nga këto dy prova materiale siç janë raporti i ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë i datës 24.09.2018, me të cilat është kryer ekzaminimi daktiloskopik i dëshmiave një karikator me pesë fishek, një pistoletë e tipit Zastava M57 e kalibrit 7.62, 25mm, me numër serik 70055, dhe dëshmia një gëzhgojë si dhe nga raporti i ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë e datës 19.03.2020, me rastin e analizimit të dëshmiave mikrogjurmë (fije floku) marr nga vendi i ngjarjes, ulësja e djathtë e pasagjerit të veturës të gjetur në vendin e ngjarjes, dhe mikrogjurmë (fije floku), është e vërtetë se këto prova materiale nuk është gjetur ndonjë lidhje me të akuzuarën Mimoza Pajaziti, mirëpo trupi gjykues ka vlerësuar se edhe pse këto prova kanë përjashtuar ndonjë lidhje të akuzuarës Mimoza, me veprën penale, janë provat tjera të cilat do të paraqiten më poshtë e nga të cilat është vërtetuar se e akuzuara Mimoza Pajaziti ka kryer veprat penale për të cilat është shpallur fajtorë”. (iv) Në lidhje me komunikimet e parashtrueses së kërkesës më viktimën, Gjykata Themelore theksoi “vërtetohet se i ndjeri A.K, përmes rrjetit social WhatsApp ka pasur komunikim me të akuzuarën Mimoza Pajaziti në numrin e telefonit 0xxxxxxx në ora 20.36 dhe po ashtu edhe nga hartografia e nxjerrë nga zyra ligjore e PTK-Vala, është vërtetuar përmes telefonit të saj është vërtetuar edhe prezenca e të pandehurës në afërsi të vendit të ngjarjes pasi që e njëjta ka qenë e kyçur me valë të telefonisë mobile nga antenat e PTK-Vala, e cila e mbulon edhe hapësirën ku edhe ka ndodhur rasti ditën kritike”. Në lidhje me largimin e parashtrueses së kërkesës nga Kosova, Gjykata Themelore arsyetoi se “nga ky raport i policisë kufitare të Kosovës vërtetohet se e akuzuara Mimoza Pajaziti me datë 30.08.2018 në ora 10.24 ka hyrë në Republikën e Kosovës përmes Aeroportit të Prishtinës, dhe e njëjta me datë 31.08.2018 në ora 22.30 e ka lëshuar Republikën e Kosovës përmes pikës kufitare Dheu i Bardhë...”.

21. Parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të procedurës penale. Parashtruesja e kërkesës kërkoi që çështja të rikthehej në rigjykim. Parashtruesja e kërkesës pretendonte që Gjykata Themelore nuk i kishte vlerësuar drejtë provat e administruara dhe nuk i kishte marrë parasysh provat shfajësuese:

provat e siguruara në vendin e ngjarjes, armën, karikatorin, gëzhøjë, mostrat e ADN-së dhe raportin e autopsisë në lidhje me kohën e vdekjes së viktimës.

22. Më 14 maj 2021, Gjykata e Apelit e aprovoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të bazuar, e anuloi Aktgjykimin [PAKR. nr. 168/21] e Gjykatës Themelore dhe e riktheu çështjen në rigjykim. Gjykata e Apelit arsyetoi si në vijim: (i) Në lidhje me prezencën e parashtrueses së kërkesës në vendin e ngjarjes, Gjykata e Apelit konstatoi se *“gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur ta vërtetojë saktë prezencën e të akuzuarës M.P. në vendin e ngjarjes në natën kritike”*. Gjykata e Apelit e udhëzoi Gjykatën Themelore që në procesin e rigjyimit *“të shikoj videot e nxjerra nga kamerat e sigurisë nga pompa e benzinës në fshatin Balaj, të vërtetojë se përveç të ndjerit a shihet duke lëvizur në atë pjesë e akuzuara ngase e njëjta ka mohuar të ketë qenë në atë pjesë”*. (ii) Në lidhje me provat shfajësuese, Gjykata e Apelit theksoi se: *“Nga provat e siguruara nga zyrtarët e policisë së Kosovës vërtetohet se në vendin e ngjarjes, respektivisht në veturën ku është kryer vrasja është gjetur një revole, karikator i saj jashtë veturës dhe 1 gëzhøjë. Mirëpo nga ekspertimi daktiloskopik i këtyre provave nuk janë gjetur gjurmë të gishtërinjve të akuzuarës dhe se nga kjo gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur të vërtetojë se e njëjta a e ka përdorur këtë armë dhe ka ketë kryer veprën penale që i vihet në barrë. Gjithashtu nga shkresat e lëndës shihet se edhe fijet e flokëve të gjetura në veturën në të cilën është kryer vepra penale pas ekspertizës së kryer është konstatuar se të njëjtat nuk i takojnë të akuzuarës Mimoza Pajaziti dhe se ato janë së paku të dy personave të tjerë të panjohur, ndërsa Mimoza është përjashtuar si kontribuuese e ADN-së në këto prova”*. Gjykata e Apelit theksoi se Gjykata Themelore *“provat shfajësuese nuk i ka vlerësuar dhe arsyetuar në mënyrë të duhur”*. (iii) Në lidhje me kohën e vrasjes së viktimës, Gjykata e Apelit theksoi se *“Të dëgjohet edhe eksperti mjeko-ligjor i cili do të deklarohet lidhur me kohën e saktë të vrasjes së të akuzuarit sepse i njëjti ka konstatuar se koha e vdekjes së A.K është ora 22 e datës 31.08 2018, ndërsa nga të dhënat zyrtare të SMK-së është vërtetuar se në orën 22.30 të datës 31.08.2018 e akuzuara ka kaluar në pikën kufitare Dheu i Bardhë nga territori i Kosovës në territorin e Serbisë, e që kjo paraqet distancë të largët”*.

Procedura e rigjyimit

23. Më 6 maj 2022, në rigjykim, Gjykata Themelore përmes Aktgjyimit [2021:149284] e shpalli përsëri fajtores parashtruesen e kërkesës për veprat penale të lartcekura, dhe ia shqiptoi dënimin me burgim prej 18 (tetëmbëdhjetë) viteve. Gjykata Themelore konstatoi si në vijim: (i) Në lidhje me prezencën e parashtrueses së kërkesës në vendin e ngjarjes, Gjykata Themelore arsyetoi se kamerat e sigurisë vërtetonin faktin që viktimë ishte duke lëvizur me veturë pranë vendit të ngjarjes në kohën e vrasjes së tij. Sa i përket vendndodhjes së parashtrueses së kërkesës, Gjykata Themelore arsyetoi se komunikimet elektronike të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dëshmojnë faktin që parashtruesja e kërkesës dhe viktimë kishin biseduar me njëri-tjetrin dhe kishin planifikuar të takoheshin në vendin dhe kohën kur ndodhi ngjarja. Gjithashtu, Gjykata Themelore theksoi se nëpërmjet raportit ligjor të PTK-Vala dhe numrit të telefonit të parashtrueses së kërkesës, u vërtetua fakti se parashtruesja e kërkesës ndodhej afër vendit të ngjarjes në kohën kur u krye krimi. (ii) Në lidhje me provat shfajësuese, Gjykata Themelore theksoi se provat shfajësuese për parashtruesen e kërkesës nuk zbehin provat e tjera materiale të cilat vërtetojnë se parashtruesja e kërkesës e kreu veprën penale për të cilën u shpall fajtores. Gjykata Themelore arsyetoi se gjurmët e gjetura në veturën e viktimës nuk përkonin me parashtruesen e kërkesës, megjithatë, në veturën e viktimës kanë mundur të ishin persona të tjerë, përfshirë familjarë të tij, gjatë kohës që viktimë e ka vozitur atë veturë. (iii) Në lidhje me kohën e vdekjes së viktimës, Gjykata Themelore konstatoi se *“eksperti kur është*

pyetur nga kryetari i trupit gjykues se në bazë të fakteve dhe provave që ka pasur në dispozicion me rastin e përpilimit me shkrim të raportit të autopsisë dhe plotësimit të këtij raporti lidhur me kohën e saktë të vdekjes e në bazë të këtij raporti është konstatuar se në bazë të shenjave kufomore koha e vdekjes së të ndjerit rezulton të jetë jo më pak se 24 orë më përpara nga momenti i ekzaminimit të vendit të ngjarjes dhe se asnjëherë nuk mund të deklarohemi për kohën e saktë të vdekjes, por si ekspert ka deklaruar për kohën e përafërt të vdekjes, që në rastin konkret ekzaminimi i vendit të ngjarjes ka ndodhur rreth orës 19.00 të datës 02.09.2018”. Gjykata Themelore ritheksoi se “sa i përket të dhëna zyrtare nga SMK (sistemi për menaxhimin e kufijve), në raportin me shkrim është konstatuar se e akuzuara Mimoza Pajaziti me datë 31.08.2018 në ora 22.30.44 ka kaluar pikën kufitare Dheu i Bardhë nga territori i Kosovës në territorin e Serbisë”.

24. Parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Parashtruesja e kërkesës propozoi që çështja të kthehej në rivendosje. Parashtruesja e kërkesës pretendonte që Gjykata e shkallës së parë nuk i kishte vlerësuar mirë provat dhe me asnjë provë nuk vërtetohej se ajo e kishte kryer veprën penale. Sipas saj, gjurmët e gjetura në vendin e ngjarjes dhe mospërputhja e ADN-së së saj me provat e gjetura, dëshmonin që ajo nuk e kishte kryer veprën penale, dhe se Gjykata Themelore nuk e kishte vërtetuar ekzistencën e saj në vendin e kryerjes së veprës penale.
25. Më 30 shtator 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 430/2022] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit arsyetoi si në vijim: (i) Në lidhje me prezencën e parashtrueses së kërkesës në vendin e krimit, Gjykata e Apelit vlerësoi që provat e administruara nga Gjykata Themelore, komunikimet elektronike ndërmjet parashtrueses së kërkesës dhe ekzaminimi i telefonit të parashtrueses së kërkesës, dëshmuar që parashtruesja e kërkesës ndodhej në vendin e ngjarjes dhe në kohën kur ndodhi vrasja. Edhe dëshmitë e dëshmitarëve vërtetuan faktin që parashtruesja e kërkesës dhe viktimja kishin kontaktuar me njëri-tjetrin. (ii) Në lidhje me provat shfajësuese, Gjykata e Apelit theksoi se Gjykata Themelore “për provat kontradiktore, ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par. 7 të KPPK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyes i merr si të provuara ose si të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore, pra, ajo ka vënë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë”. Gjykata e Apelit vlerësoi se përkundër disa provave shfajësuese, Gjykata Themelore në mënyrë të pakontestueshme e vërtetoi faktin që parashtruesja e kërkesës e kreu vrasjen e viktimës. (iii) Në lidhje me largimin e parashtrueses së kërkesës nga vendi i ngjarjes, Gjykata e Apelit theksoi se parashtruesja e kërkesës kishte ardhur nga Gjermania një ditë para ngjarjes, ndërsa pas kryerjes së vrasjes e kishte kaluar pikën kufitare për tu kthyer në Gjermani.
26. Parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe dispozitave të procedurës penale, dhe propozoi që çështja të rikthej në rivendosje dhe të anuloheshin aktgjykimet e lartcekura. Parashtruesja e kërkesës përsëriti pretendimet edhe në kërkesën e parashtruar në Gjykatën Supreme.
27. Më 22 dhjetor 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 474/2022] e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtrueses së kërkesës dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme arsyetoi si në vijim: (i) Në lidhje

me prezencën e parashtrueses së kërkesës në vendin e ngjarjes, Gjykata Supreme vlerësoi që gjykatat e rregullta përmes komunikimeve elektronike dhe raportit të PTK-Vala, e vërtetuan faktin që parashtruesja e kërkesës ishte prezente në vendin e ngjarjes dhe në kohën e kryerjes së veprës penale. Gjithashtu, u vërtetua që parashtruesja e kërkesës dhe viktimat kishin komunikuar me njëri-tjetrin dhe kishin planifikuar takimin në atë kohë. (ii) Në lidhje me provat shfajësuese, Gjykata Supreme theksoi se ishin marrë parasysh të gjitha provat dhe ishin vlerësuar të gjitha në mënyrë të drejtë. Gjykata Supreme vlerësoi që Gjykata Themelore përmes provave të tjera e vërtetoi në mënyrë të pakontestueshme që parashtruesja e kërkesës e kreu veprën penale. (iii) Në lidhje me kohën e kryerjes së veprës penale, Gjykata Supreme arsyetoi se ekspertiza mjeko-ligjore kishte konstatuar vetëm në mënyrë të përafërt kohën se kur ndodhi vrasja. (iv) Gjykata Supreme theksoi se raporti i policisë kufitare vërtetoi faktin që parashtruesja e kërkesës u largua nga Kosova pas kryerjes së veprës penale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e saj kushtetuese të garantuara me nenet 21 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

(i) Përkitazi për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës

29. Parashtruesja e kërkesës pretendon se “Siç është sqaruar në pjesën hyrëse të kësaj kërkesë, kemi disa vendime të kundërligjshme të gjykatave si të asaj themelore e sidomos të Gjykatës së Apelit, ku dy kolegje të ndryshme të saj kanë nxjerrë vendime krejtësisht të ndryshme, të kundërta e të cilat vendime kanë efekt direkt në këtë çështje. Sipas vendimit të parë të Gjykatës së Apelit, është aprovuar ankesa e mbrojtjes dhe çështja është kthyer në rigjykim ku për gjykatën e shkallës së parë janë dhënë disa udhëzime se si të veprojnë me rastin e rigjykimit të çështjes. Ndër më kryesoret kanë qenë vërtetimi i faktit nëse Mimoza Pajaziti ka qenë në vendin e ngjarjes, të vërtetohet fillimisht prezenca e saj në vendin e ngjarjes, të merret në pyetje eksperti mjeko-ligjor për të përcaktuar saktë kohën e vdekjes dhe disa udhëzime të tjera”.
30. Parashtruesja e kërkesës pretendon se “Çështja penale është kthyer në rigjykim me udhëzime të qarta nga Gjykata e Apelit, mirëpo asnjë nga udhëzimet e dhëna nga Gjykata e Apelit nuk është përfillur nga Gjykata Themelore në Ferizaj me rastin e rigjykimit të çështjes dhe kjo shihet qartë në aktgjykimin me numër 2021:149284 të datës 06.05.2022, pra duke mos iu përmbajtur asnjë udhëzimi nga Apeli dhe duke mos e vërtetuar prezencën e Mimoza Pajazitit në vendin e ngjarjes e as duke mos e vërtetuar kohën e vdekjes, nga dëgjimi i dëshmitarit ekspertit mjeko-ligjor, Gjykata Themelore e përsërit vendimin e parë dhe përsëri e dënon Mimoza Pajazitin me 18 vite burgim”.
31. Parashtruesja e kërkesës pretendon se “Rregullsia e procesit gjyqësor kundër M.P. ka devijuar vazhdimisht ku fillimisht gjykata e shkallës së parë në rigjykim nuk iu përmbahet udhëzimeve të Apelit, pastaj Kolegji i dytë i Gjykatës së Apelit nxjerrë një vendim krejtësisht të kundërt me Kolegjin e parë dhe me këtë rast cenohet rëndë parimi i një procesi të rregullt ndaj M.P”.
32. Sipas parashtrueses së kërkesës, “Gjykata e Apelit nuk është marrë me pretendimet tona, nuk është marrë me faktin se përse Gjykata Themelore nuk iu është përmbajtur

udhëzimeve të dhëna paraprakisht nga Gjykata e Apelit, por për fat të keq kolegji i Apelit në trajtimin e dytë të kësaj çështje ka kaluar mandatin e saj, ka shkelur ligjin dhe duke u marrë me vërtetimin e gjendjes faktike dhe me arsyetimin e vendimit të Gjykatës së shkallës së parë”.

33. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon se “Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës përmban shumë shkelje sepse duke parë pretendimet ankimore të mbrojtjes së Mimoza Pajazitit, duke parë llojin e veprës për të cilën është akuzuar e njëjta, lartësinë e dënimit dhe faktorë të tjerë, Gjykata Supreme minimalisht do të duhej të mbaj një seancë të hapur, ku do t'i ftonte palët dhe të dëgjonte pretendimet e tilla”.

(ii) Përkitazi për shkeljen e nenit 32 të Kushtetutës

34. Në lidhje me përdorimin e mjeteve juridike, parashtruesja e kërkesës pretendon se “Shkelja e kësaj të drejte ka të bëjë me faktin se mjetet juridike të ushtruara nga M.P. nuk janë trajtuar seriozisht dhe për tu përmbushur kjo pikë nuk mjafton që palës ti lejohet që në aspektin formal ti drejtohet gjykatës së shkallës tjetër duke ushtruar të drejtën për mjet juridik. Por interpretimi i kësaj dispozite shkon deri aty sa që garanton që edhe trajtimi i mjetit juridik duhet të bëhet në mënyrë efektive të paanshëm dhe profesionale e cila gjë nuk është bërë nga kolegjet e gjykatës së Apelit”. Sipas parashtrueses së kërkesës, “shkelja e lartpërmendur ka për pasojë edhe shkeljen e nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës”.
35. Parashtruesja e kërkesës thekson se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e saja kushtetuese dhe ligjore. Ajo kërkon nga Gjykata që (i) ta deklarojë kërkesën e pranueshme; (ii) ta aprovojë kërkesën në tërësi si të bazuar dhe (iii) ta prishë aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe çështjen ta kthejë në rigjykim në shkallën e parë.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
 4. Çdokush i akuzuar për veprë penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
 5. Çdokush i akuzuar për veprë penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
- [...]

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
[...]

Neni 13

E drejta për zgjidhje efektive

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

LIGJI Nr. 06/L - 054 PËR GJYKATAT

KAPITULLI III

STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE KOMPETENCAT E GJYKATAVE

Neni 8

Struktura organizative

1. Sistemi i gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.
2. Degët themelohen brenda territorit të një Gjykate Themelore. Themelimi i degëve të reja, apo i departamenteve të cilat nuk janë përcaktuar në këtë ligj, apo bashkimi i degëve, bëhet vetëm me ligj.

Neni 12

Juridiksioni i Gjykatës Themelore sipas Lëndës

1. Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.
[...]

Neni 22

Kompetencat e Gjykatës së Apelit

1. Gjykata e Apelit është kompetente të shqyrtojë: 1.1. të gjitha ankesat e ushtruara kundër vendimeve të Gjykatave Themelore;
- 1.2. të vendos për konfliktin e juridiksionit ndërmjet Gjykatave Themelore;
- 1.3. çështjet tjera të parapara me ligj.

Neni 26

Kompetencat e Gjykatës Supreme

1. Gjykata Supreme është kompetente të vendosë lidhur me:
- 1.1. kërkesën për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Republikës së Kosovës, siç është paraparë me ligj;

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

36. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

38. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”

39. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ajo konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 474/2022] e 22 dhjetorit 2022 të Gjykatës Supreme, pasi që i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
40. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me nënrregullin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 34

[Kriteret e pranueshmërisë]

(2) “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk e mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”
[...]

41. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës*, nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës*, nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij/saj (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij/saj dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin e Gjykatës *KI166/20*, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e GJEDNJ-së *Kemmache kundër Francës*, nr. 17621/91, Aktgjykim i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), *Juta Mentzen kundër Lituanisë*, nr.

71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe, kategoria (iii) Trofimchuk kundër Ukrainës, Aplikimi nr. 4241/03.

Pretendimet për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës

(i) Përkitazi me vlerësimin dhe administrimin e provave

42. Gjykata rikujton pretendimin e parashtrueses se “Rregullsia e procesit gjyqësor kundër M.P. ka devijuar vazhdimisht ku fillimisht gjykata e shkallës së parë në rigjykim nuk iu përmbahet udhëzimeve të Apelit, pastaj Kolegji i dytë i Gjykatës së Apelit nxjerrë një vendim krejtësisht të kundërt me Kolegjin e parë dhe me këtë rast cenohet rëndë parimi i një procesi të rregullt ndaj M.P.” Sipas parashtrueses së kërkesës, “Gjykata e Apelit nuk është marrë me pretendimet tona, nuk është marrë me faktin se përse Gjykata Themelore nuk iu është përmbajtur udhëzimeve të dhëna paraprakisht nga Gjykata e Apelit, por për fat të keq kolegji i Apelit në trajtimin e dytë të kësaj çështje ka kaluar mandatin e saj, ka shkelur ligjin dhe duke u marrë me vërtetimin e gjendjes faktike dhe me arsyetimin e vendimit të Gjykatës së shkallës së parë”.

a) Parimet e përgjithshme në lidhje me administrimin dhe vlerësimin e provave

43. Gjykata përsërit se, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, çështja e administrimit dhe vlerësimit të provave është brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta. Nuk është detyrë e Gjykatës të merret me gabimet e faktit ose të ligjit, përveç rasteve kur ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara nga Kushtetuta dhe Konventa. Gjatë vlerësimit nëse procedurat e ndjekura gjyqësore ishin të drejta, Gjykata nuk vepron si “shkallë e katërt” në lidhje me mënyrën e marrjes së provave, pranueshmërinë e tyre apo fajësinë e parashtruesit të kërkesës. Këto janë çështje të gjykatave të rregullta. Gjykata nuk mund të vlerësojë nëse provat e paraqitura ishin të mjaftueshme për shpalljen fajtor ose jo të parashtruesit, ose të ndryshojë vlerësimin e gjykatave të rregullta për faktet dhe provat e administruara. Gjykata vetëm vlerëson nëse gjithë procedura në tërësi ishte e drejtë, në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, duke marrë parasysh rrethanat, natyrën dhe kompleksitetin e rastit (rasti i GJEDNJ-së Lamatric kundër Rumanisë, nr. 55859/15, Aktgjykim i 1 dhjetorit 2020, para. 42; Murtazaliyeva kundër Rusisë, nr. 36658/05, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2018, para. 149; rasti i Gjykatës, KI122/19, parashtrues F.M, aktvendim për papranueshmëri i 9 korrikut 2020, para. 66-69).
44. Gjykata rithekson se aspekti që duhet shqyrtuar është nëse procedura, duke përfshirë mënyrën se si janë mbledhur provat, ka qenë e rregullt në tërësinë e saj. Nëse procedura ishte e drejtë, duhet pasur parasysh nëse janë respektuar të drejtat e mbrojtjes. Në lidhje me këtë, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës kishte mundësi të kontestonte ligjshmërinë e provave dhe të kundërshtonte përdorimin e tyre (rasti i Gjykatës KI17/22 dhe 22/22, parashtrues Hazir Krasniqi dhe Durim Krasniqi, Aktvendim për papranueshmëri i 22 dhjetorit 2022, para. 108-111; KI98/21, parashtrues Nexhat Sadiku dhe Gursel Sadiku, Aktvendim për papranueshmëri i 3 marsit 2022, para. 62-63).
45. Gjykata ripërsërit se roli i saj nuk është të përcaktojë pranueshmërinë e provave ose jo, e as të përcaktojë nëse parashtruesja e kërkesës është fajtor apo jo. Gjykata duhet të vlerësojë nëse procedura si tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë provat ishte e drejtë (rasti i Gjykatës KI34/18, parashtrues Albert Berisha, Aktvendim për papranueshmëri i 23 majit 2018, para. 49).

(b) Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

46. Gjykata rikujton se Gjykata Themelore dënoi parashtruesen e kërkesës për veprën penale “Vrasje e rëndë” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, dhe ia shqiptoi dënimin në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) viteve.
47. Gjykata e Apelit duke vendosur mbi bazën e ankesës së parashtrueses së kërkesës, ktheu çështjen në rigjykim dhe udhëzoi Gjykatën Themelore që të rivlerësonte provat. Gjykata e Apelit e udhëzoi Gjykatën Themelore që në procesin e rigjykimit: (i) të vërtetonte prezencën e parashtrueses së kërkesës në vendin e ngjarjes; (ii) të vlerësonte provat shfajësuese për parashtruesen e kërkesës; dhe (iii) të konstatonte koha e vrasjes së viktimës.
48. Gjykata Themelore në rigjykim shqiptoi dënim të njëjtë për parashtruesen e kërkesës në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) viteve. Gjykata vëren se Gjykata Themelore në procesin e rigjykimit dha arsyetimet e saj në lidhje me kërkesat e Gjykatës së Apelit. (i) Në lidhje me prezencën e parashtrueses së kërkesës në vendin e ngjarjes, Gjykata Themelore arsyetoi se komunikimet elektronike dëshmonin që parashtruesja e kërkesës dhe viktimë kishin komunikuar me njëri-tjetrin dhe kishin planifikuar të takoheshin në vendin e ngjarjes dhe në kohën kur ndodhi vrasja. Po ashtu, Gjykata Themelore theksoi se në bazë të ekzaminimit të telefonit të parashtrueses së kërkesës dhe raportit të PTK-Vala, u dëshmuar prezenca e saj në vendin e ngjarjes. (ii) Sa i përket provave shfajësuese, Gjykata Themelore theksoi se disa gjurmë të gjetura në veturën e viktimës nuk i takonin parashtrueses së kërkesës. Megjithatë, ekzistonin provave të tjera që dëshmuar se parashtruesja e kërkesës e kishte kryer veprën penale. (iii) Ndërkaq për kohën e vrasjes së viktimës, Gjykata Themelore arsyetoi se eksperti e kishte konstatuar vetëm kohën e përafërt të vrasjes së viktimës dhe koha e konstatuar përputhej me e kohën e largimit të parashtrueses së kërkesës nga Kosova, menjëherë pas kryerjes së veprës penale.
49. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme i mbështetën në tërësi të gjitha konstatimet e Gjykatës Themelore dhe vlerësuan që provat e administruara nga Gjykata Themelore dëshmuar në mënyrë të pakontestueshme që parashtruesja e kërkesës e kishte kryer veprën penale.
50. Në lidhje me pretendimin se Gjykata Themelore në rigjykim nuk mori parasysh udhëzimet e Gjykatës së Apelit, Gjykata vëren se në rigjykim u adresuan të gjitha çështjet kryesore që lidheshin me kryerjen e veprës penale. Gjykata Themelore vlerësoi dhe mori parasysh edhe provat shfajësuese për parashtruesen e kërkesës dhe nuk i mohoi ato. Mirëpo, ato nuk ishin provat e vetme që u administruan gjatë procesit gjyqësor. Sipas Gjykatës Themelore, provat e tjera materiale dëshmuar fajësinë e parashtrueses së kërkesës. Një konstatim të tillë e mbështetën edhe gjykatat e instancës më të lartë.
51. Gjykata përsërit se nuk është detyrë e saj të vlerësojë provat e administruara nga gjykatat e rregullta, të përcaktojë fajësinë apo jo, e as të vlerësojë nëse provat e administruara ishin të mjaftueshme për shpalljen fajtor të parashtrueses së kërkesës. Në rastin konkret, gjykatat e rregullta vlerësuan një numër të caktuar të provave, të cilat i vlerësuan si të mjaftueshme dhe të pakontestueshme për shpalljen fajtores të parashtrueses së kërkesës.
52. Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës nuk kishte propozuar marrjen e ndonjë prove e të cilën gjykatat e rregullta nuk ia kishin pranuar. Me fjalë të tjera, gjatë procesit gjyqësor parashtruesja e kërkesës nuk ishte në disavantazh me prokurorinë në lidhje me propozimin e provave dhe kundërshtimin e tyre.

53. Parashtruesja e kërkesës kishte mundësinë t'i kontestonte provat para gjykatave të rregullta, përfshirë Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme. Shikuar në tërësi, Gjykata vlerëson se procedura gjyqësore ndaj parashtrueses së kërkesës përfshirë mënyrën e marrjes dhe vlerësimit të provave ishte e drejtë.

54. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtrueses së kërkesës përkitazi me vlerësimin e provave i përkasin kategorisë së pretendimeve që konsiderohen me “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, prandaj shpallen të papranueshme sipas rregullit 34 (2) të Rregullores së punës.

(ii) Përkitazi me mosmbajtjen e seancës dëgjimore në Gjykatën Supreme

55. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon që Gjykata Supreme nuk mbajti seancë të hapur, ku do t'i ftonte palët për t'i paraqitur pretendimet e tyre. Sipas saj, një gjë e tillë ishte e nevojshme duke marrë parasysh llojin e veprës penale dhe lartësinë e dënimit.

56. Gjykata thekson se mbajtja e seancës dëgjimore është e rëndësishme sidomos në çështjet penale. Kur një person është i akuzuar për një vepër penale duhet që të jetë i pranishëm në gjykimin e shkallës së parë, dhe t'i jepet mundësia për të propozuar prova, dëgjuar provat kundër tij/saj dhe dëgjuar dëshmitarët (rasti i GJEDNJ-së *Jussila kundër Finlandës*, nr. 73053/01, Aktgjykim i 23 nëntorit 2006, para. 49). Detyrimi për të garantuar të drejtën e të akuzuarit për pjesëmarrje në seancë dëgjimore është një nga elementet kryesore të procesit të drejtë gjyqësor, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (rasti i GJEDNJ-së *Hermi kundër Italisë*, nr. 18114/02, Aktgjykim i 18 tetorit 2006, para. 58-59).

57. Gjykata thekson se bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, e drejta e të akuzuarit për pjesëmarrje në seancë përfshin të drejtë për të marrë pjesë edhe në seancën dëgjimore të apelit. Parimi i publicitetit ka për qëllim respektimin e të drejtave të të akuzuarit (rasti i GJEDNJ-së *Tierce dhe të tjerët kundër San Marinos*, nr. 24954/94, Aktgjykim i 25 korrikut 2000, para. 95).

58. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ishte prezente në seancat dëgjimore të mbajtura në Gjykatën Themelore. Gjithashtu, edhe Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë mbajti seancë dëgjimore dhe parashtruesja e kërkesës ishte prezente. Të dyja këto instanca gjyqësore përmbushën detyrimin e tyre ligjor për të mbajtur seanca dëgjimore dhe për të garantuar të drejtën e parashtrueses së kërkesës, e akuzuar në këtë rast, për të marrë pjesë personalisht në seanca gjyqësore. Në këtë rast, parashtruesja e kërkesës ka pasur mundësi të dëgjonte rastin kundër saj, të dëgjonte provat dhe dëshmitarët dhe për t'i paraqiste kundërshtimet e saj.

59. Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme është dashur të mbaj seancë dëgjimore dhe t'i ftonte palët të merrnin pjesë. Gjykata vëren se neni 407.2 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se:

“Gjykata Supreme e Kosovës vendos për ankesat kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në seancë të kolegjit të gjyqtarëve përshtatshmërisht me dispozitat që vlejnë për procedurë ankimore në Gjykatën e Apelit. Në Gjykatën Supreme nuk mund të mbahet shqyrtim”.

60. Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta e përmbushën detyrimin e tyre ligjor dhe gjithë procedura në tërësi ishte e drejtë. Prandaj, parashtruesja e kërkesës gjatë gjithë procesit gjyqësor e kishte mundësinë që të dëgjohej, të merreshin parasysh propozimet dhe kundërshtimet e saj në lidhje me çështjet e faktit dhe të ligjit.
61. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtrueses së kërkesës përkitazi me mosmbajtjen e seancës dëgjimore i përkasin kategorisë së pretendimeve që konsiderohen me “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, prandaj shpallen të papranueshme sipas rregullit 34 (2) të Rregullores së punës.

Pretendimet për shkeljen e nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të Konventës

62. Parashtruesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta ia kanë mohuar të drejtën për përdorimin e mjetit juridik, për shkak se, arsyeton ajo, mjetet juridike të përdorura nuk u trajtuan seriozisht nga gjykatat e rregullta. Sipas parashtrueses së kërkesës, përdorimi i mjetit juridik nuk nënkupton vetëm përdorimin formal të tij, por trajtim efektiv dhe të paanshëm nga gjykatat e rregullta.
63. Gjykata rikujton se neni 32 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të Konventës, përcakton se sistemi juridik duhet të vë në dispozicion një mjet efektiv juridik që autorizon organin kompetent të adresojë thelbin e një pretendimi për shkelje të Kushtetutës dhe Konventës (rasti i GJEDNJ-së *Sharxhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 10613/16, Aktgjykim i 11 janarit 2018, para. 81; rasti i Gjykatës *KI193/18*, parashtrues Agron Vula, Aktgjykim i 22 prillit 2020, para. 131). Neni 13 i Konventës i obligon shtetet që të ofrojnë mjete juridike efektive që mundësojnë shqyrtimin e thelbit të një kërkesë për të mundësuar korrigjimi të duhur. Mjeti juridik duhet të jetë “*efektiv*” sipas ligjit dhe në praktikë (rasti i GJEDNJ-së *Kudla kundër Polonisë*, nr. 30210/96, Aktgjykim i 26 tetorit 2000; rasti i Gjykatës *KI86/18*, Aktgjykim i 3 shkurtit 2021, para. 124-125).
64. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës kishte shterur të gjitha mjetet juridike të cilat i kishte në dispozicion: dy ankesa në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
65. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtrueses së kërkesës ishte i njëjtë në të gjitha instancat. Ajo pretendonte se provat nuk ishin vlerësuar dhe administruar si duhet, dhe në asnjë mënyrë nuk ishte vërtetuar fajësia e saj në lidhje me veprën penale për të cilën u dënua me burgim.
66. Gjykata vëren se ankesa e parë e parashtrueses së kërkesës e parashtruar në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore ishte e suksesshme, sepse ankesa ishte pranuar si e bazuar nga Gjykata e Apelit dhe çështja u kthye në rigjykim. Megjithatë, ankesa e dytë e parashtrueses së kërkesës e ushtruar në Gjykatën e Apelit në procedurën e rigjykimit dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e ushtruar në Gjykata Supreme nuk patën sukses, sepse u refuzuan si të pabazuara.
67. Në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës nuk është e kënaqur me rezultatin e arritur nga përdorimi i mjeteve juridike. Gjykata thekson se përdorimi i mjetit juridik nuk garanton rezultat të favorshëm për palën (rastet e GJEDNJ-së *Kudla kundër Polonisë*, nr. 30210/96,

Aktgjykim i 26 tetorit 2000, para. 157; Costello-Roberts kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 13134/87, para. 40).

68. Mjeti juridik mund të konsiderohet efektiv edhe në rastet kur gjykatat e rregullta i kanë rrëzuar të gjitha pretendimet e palës në kontest. Efektiviteti i mjetit juridik nuk matet nga rezultati përfundimtar i arritur, por nga fakti nëse pretendimet e ngritura janë trajtuar thellësisht në merita nga ana e autoriteteve gjyqësore (rastet e GJEDNJ-së Swedish Engine Drivers' Union kundër Suedisë, nr. 5614/72, para. 50; Amann kundër Zvicrës, nr. 27798/95, para. 89-90).
69. Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta i vlerësuan në thelb të gjitha pretendimet që ngriti parashtruesja e kërkesës. Mjeti juridik i përdorur nga parashtruesja e kërkesës nuk ishte vetëm formal, por u trajtuan në merita të gjitha pretendimet e saj.
70. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtrueses së kërkesës përkthazi me përdorimin e mjetit juridik, i përkasin kategorisë së pretendimeve që konsiderohen me “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, prandaj shpallen të papranueshme sipas rregullit 34 (2) të Rregullores së punës.

Pretendimet për shkeljen e nenit 24 dhe 54 të Kushtetutës

71. Parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e neneve 24 dhe 54 të Kushtetutës. Megjithatë, parashtruesja e kërkesës vetëm i ka përmendur këto nene të kushtetutës në ndërlidhje me pretendimin e saj kryesor për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, përkthazi me vlerësimin e provave.
72. Gjykata përsërit se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së ose ndërlidhja e tyre me një nen tjetër të Kushtetutës nuk nënkupton vetvetiu edhe shkelje të neneve tjera të Kushtetutës ose të KEDNJ-së, nëse më tej nuk argumentohet dhe shtjellohet në nivel kushtetutshmërie se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e tyre. Gjykata vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI175/20, me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi për papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 81; dhe së fundmi rastin KI04/21, me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
73. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkeljen e nenit 24 dhe 54 të Kushtetutës, i përkasin kategorisë së pretendimeve që karakterizohen si “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, prandaj shpallen të papranueshme sipas rregullit 34 (2) të Rregullores së punës.

Përfundime

74. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se: (I) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së dytë (ii), pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, prandaj, si të tilla, këto pretendime në baza kushtetuese deklarohen qartazi të pabazuara; (II) pretendimet e parashtrueses së

kërkesës për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 të Konventës, i përkasin kategorisë së dytë (ii), pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*, prandaj, si të tilla, në baza kushtetuese edhe këto pretendime shpallen qartazi të pabazuar; dhe (III) pretendimet për shkeljen e nenit 24 dhe 54 të Kushtetutës, i përkasin kategorisë së tretë (iii), *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*, prandaj, si të tilla, këto pretendime në baza kushtetuese deklarohen qartazi të pabazuara.

75. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, në pajtueshmëri me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, duhet deklaruar e papranueshme si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47.1 të Ligjit dhe me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, më 31 janar 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- III. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Selvete Gërxhaliu Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani